



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ Prot.
më ____/____/2025

Gramsh

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË.

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion i rrugës automobilistike fshati Mazreke”

KODI NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime rrugore 45233140-2

VLERA E FONDIT LIMIT: me fond limit 5 166 665 (pesë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtë e pesë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7.1.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore 3 (tri) viteve të fundit financiare lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Gramsh, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të

fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se sa fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njërës prej kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vleresimi i pervojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar ne dokumentat e meposhtme:

- i) Per kontrata te realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet te paraqes/in dokumentacionin e meposhtem, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, per te vertetuar permbushjen e suksesshme te puneve:
 - 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqeruar me:
 - 2. Kontraten/at e Sipermarrjes;
 - 3. Situacionin perfundimtar te objektit;
 - 4. Aktin e kolaudit;
 - 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim;
 - 1. Faturat tatimore perfundimtare te deklaruar ne organet tatimore

Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktesisht cilesine e kryerjes se puneve, faktin nese kontrata eshte realizuar me sukses, perqindjen e punimeve ne rast bashkimi te shoqerive, etj.

- ii) Per kontrata te realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet te paraqes/in dokumentacionin e meposhtem:
 - 2. Vertetim te leshuar nga subjekti per realizimin e punimeve me sukses, shoqeruar me :
 - 3. Kontraten/at e Sipermarrjes;
 - 4. Situacionin perfundimtar te objektit;
 - 5. Aktin e kolaudit; (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
 - 6. Fatura tatimore perfundimtare te deklaruar ne organet tatimore
- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;
- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1 germa “a” plotesohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Ne rastin kur operatoret ekonomike, anetare te nje bashkimi, kane te njejten perqindje pjesemarrjeje ne bashkim, vendosin me marreveshje ne kontraten e bashkepunimit se cila prej tyre do te permbushe kete kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet te plotesohet nga te gjithë anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi:

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **30%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa fondi limit i kontratës që prokurohet

Plotesimi i kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Gërma (a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse gërma (b) duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojes realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikava, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

a) Për kontratat e punëve:

i.. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit13që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë* në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP – 1 A - Punime gjurmimi në tokë

NP -- 4 A- Rrugë autostarada ,mbikalime,hekurudha,tramvai,metro, pista aeroportuale

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi”. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Konsiderohen gjurmimet, sistemitet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohej vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	A 0 – 20 mln lekë	Me e vogël se 20 mln

NP - 4	Rrugë autostrada , ura, mbikalime , hekurudha , linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.	A 0 – 20 mln lekë	Me e vogël se 20 mln
--------	---	--	-------------------------	----------------------

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- b. 1 (një) Inxhinier Gjeodet operatorëve ekonomike ju lejohet mundësia të disponohet dhe kontratë bashkëpunimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përse i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri i Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.3.1 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Me qëllim realizimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt, kjo dhe në rastin kur ofertuesi merr pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik, secili anëtar duhet të përcaktojë/ deklarojë drejtuesin teknik të punimeve, si dhe të paraqesë dokumentacionin e kërkuar.

- **2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:**

Lloji i Specialistit	Minimumi i kerkuar
• Betonues	2
• Karpentier	1
• Hekurkthyes	1
• Teknik ndertimi	1
• Punetore te thjeshte	3
• Automakinist	1

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si

më poshtë:

N r.	EmërMbiemëripunonjësit	Profesi oni	Institucionipublik/privatlëshuesicertif ikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucioni privat)
1.				
2.				
etj .				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmite/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë,

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Betonues** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjes të thjeshtë** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **1(një) shoferë** të mjeteve të rënda/kamioni dhe **1 (një)manovratorë** të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të

kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automaknist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre punonjës të specializuar/ të kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e

përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 15(pesëmbëdhjetë) punonjës të siguruar në datën e hapjes së tenderit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar). Për t'a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.

- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasitë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me zinxhirë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Fadrome	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Grejder	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri ne 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Autobot Uji 5000-10000 litra	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 8 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qira
7	Kamion me vinç me kapacitet mbajtes 5-8 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qira
8	Gjenerator	cope	1	Ne pronesi ose me qira
9	Matrapik	cope	1	Ne pronesi ose me qira
10	Rrul gome-hekur mbi 15 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qira
11	Betoniëre 0.25 m3	cope	2	Ne pronesi ose me qira
12	Minidumper pesha mbajtese 5-7 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qira
13	Rrul gome-hekur mbi 5 ton	cope	1	Ne pronesi ose me qira

Grejder

Duke u bazuar në preventiv, kjo makineri është e nevojshme për të përhapur materialin ose shkresa bazë të rrugës.

Duke qënë se kjo rrugë rurale do të rikonstruktohet me material si çakull, kjo është e nevojshme që të përhapë në mënyrë të njëtrajtshme,

Sipas volumeve që paraqiten në preventive 1 Grejder është i nevojshëm, për realizimin e zëeave të punës të përcaktuara.

Kjo makineri është e nevojshme në këtë kantier, pasi është shumë précis për rrafshimin dhe formësimin e terrenit.

Pas përfundimit të punimeve, terreni duhet rrafshuar saktësisht para se të shtrohet çakëlli apo të vendosen tombinot.

Formësimi i shtresës së çakëllit

Grejderi si makineri, do të ndihmojë për të përhapur në mënyrë të njëtrajtshme dhe me pjerrësi të kontrolluar

Formësimi i pjerrësive/drenazhimit

Në object kemi edhe vendosje tombino edhe për këtë duhet të krijohen pjerrësi për rrjedhjen e ujrave.

- **Eskavatori me zinxhir**

Kjo rrugë për nga vështirësia klasifikohet e tipit e vështirë e mbushur me baltë, e pjerrët edhe me sipërfaqe të pabarabartë. Sipas preventivit llogaritet rreth $1800 \text{ m}^3/\text{min}$. Kapaciteti i kovës së eskavatorit zakonisht varion $0.6-2.5 \text{ m}^3$. Do të konsiderojmë që ekskavatori ka kovë 1.2 m^3 , ku produktiviteti do të jetë $120 \text{ m}^3/\text{orë}$ në kushte normale pune. Duke iu referuar dhe grafikut të punimeve 48 ditë pune, për një punë 8 orë në ditë dhe kapaacitetit mesatar të ekskavatorit $120 \text{ m}^3/\text{ditë}$, llogaritja do të jetë $1800 \text{ m}^3/48 \text{ ditë} = 37.5 \text{ m}^3/\text{ditë}$. Pra, 1 ekskavator me zinxhir që të punojë rreth 2-3 orë në ditë është i mjaftueshëm për ta përfunduar punën për 48 ditë. Kamioni vetshkarkues me kapacitet mbartes deri në 20 T.

Ky mjet do të shërbejë për transportin dhe shkarkimin automatic të materialeve të ndërtimit, çakulli në këtë rast kamioni në fjalë zotëron ($=12.5 \text{ m}^3/\text{ngarkesë}$) është i mjaftueshëm për një grafik pune 48 ditë sipas preventivit:

Sipërfaqe (m^2)	Trashësia (cm)	Trashësia (m)
1100	20	0.2
1050	10	0.1
128	20	0.2

Përshkruajmë llogaritjen e vëllimit total:

$V = \text{Sipërfaqe} \times \text{Trashësi}$

- $V1 = 1100 \times 0.2 = 220 \text{ m}^3$

- $V2 = 1050 \times 0.1 = 105 \text{ m}^3$

- $V3 = 128 \times 0.2 = 25.6 \text{ m}^3$

Totali 350.6 m^3 çakëll.

Ngarkesa e një kamioni 20 T që kërkohet për realizimin e kësaj pune :

- $1 \text{ m}^3 \text{ çakëll} = 1.6 \text{ ton}$

- $\text{Zotëron}/ 1.6 = 12.5 \text{ m}^3/\text{ngarkesë}$

Llogarisim sa ngarkesa duhen gjithsej

$350.6 \div 12.5 = 28.05$ që është e vlefshme për 28 ngarkesa gjithsej.

Në rast me Grafikun e punimeve :

$28 \text{ ngarkesa} \div 48 \text{ ditë} = 0.58 \text{ ngarkesa/ditë} = 1 \text{ ngarkesë çdo } 2 \text{ ditë}.$

Pra, 1 kamion vetshkarkues me kapacitet 20 ton është i mjaftueshëm për të transportuar të gjithë çakëllin (350.6 m^3). Me një grafik pune 48 ditë ky kamion ka nevojë të bëjë vetëm 28 ngarkesa në total, mesatarisht 3 ngarkesa në javë.

- **Kamioni me vinç me kapacitet mbajtës 5 deri në 8 ton.**

Ky mjet do të jetë i nevojshëm në kantier për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të rënda, në rastin e këtij projekti Tambino (qypa betoni).

Gjithashtu ky mjet do të përdoret edhe për pozicionimin e materialeve në kantier, punë në zonë me hapësirë të kufizuar ku nuk ka vinç kulle.

Në referim të preventivit kemi 49 ml tombino, për një kohë grafike 48 ditë, $\Phi 400$ (tombinos).

Për 49 ml do të duhen 49 copë tombino, duke marrë parasysh që 1 tombino është 1 metër secila.

Duke llogaritur që pasha e një tombino $\Phi 400$ me një gjatësi 1m/tombin, peshon rreth 150 –200 kg.

Për të qenë të sigurt dhe Brenda rrezes do të konsiderojmë 200 kg.

Pra, $49 \text{ tombino} \times 200 \text{ kg} = 9800 \text{ kg} = 9.8 \text{ t}$

Për një kamion me vinç me kapacitet 5-8 ton, ai mund të ngrejë deri 2-3 tombino njerësh.

Ky kamion mund të realizojë 1-2 udhëtime .

Në referime edhe të grafikut të punimeve:

$49 \text{ tubino} \div 48 \text{ ditë} = 1.02 \text{ copë/ditë}$

Kamioni do të përdoret për 1-2 orë në ditë max.

- **Autobot uji**

Ky mjet apo kriter është i nevojshëm për të kontrolluar pluhurin Brenda kantierit, për kompaktësimin e shtresave të tokës, çakëllit në rastin e këtij projekti : Autoboti i ujit duhet të ketë ujë kapacitet standart 5000-10.000 litra ujë, ku të realizojë 3-5 spëraktje në ditë.

- **Rrul gome-hekur mbi 15 ton**

Në rikontruksionin e rrugës rurale të fshatit Mazrek është i nevojshëm dhe **1 Rrul gome-hekur mbi 15 ton.**

Në preventive janë parashikuar 3 shtresa çakëll, me trashësi të ndryshme që do mbulojnë sipërfaqe të ndryshme përkatësisht:

-Shtresa 1:

Trashësia : 10 cm = 0.10 m

Sipërfaqe : 1050 m^2

Vëllimi = $0.10 \text{ m} \times 1050 \text{ m}^2 = 105 \text{ m}^3$

-Shtresa 2:

Trashësia : 20 cm = 0.20 m

Sipërfaqe : 1100 m^2

Vëllimi = $0.20 \text{ m} \times 1100 \text{ m}^2 = 220 \text{ m}^3$

-Shtresa 3:

Trashësia : 20 cm = 0.20 m

Sipërfaqe : 128 m^2

Vëllimi = $0.20 \text{ m} \times 128 \text{ m}^2 = 25.6 \text{ m}^3$

Total i vëllimit të çakëllit që do të ngjeshet në këtë object është: $150+220+25.6=350.6 \text{ m}^3$

Kjo makineri pra rruli gomë-hekur mbi 15 ton, është i nevojshëm, pasi kemi të bëjmë relativisht me shtresa të trasha. Për këto shtresa nevojitet një kompaktim i thellë. Përkatësisht trashësitë e shtresave të çakëllit të preventivuara 10 cm dhe 20 cm kërkojnë kompaktim me energji të lartë për të arritur

dendësinë e kërkuar dhe për të shmangur zhytjet ose deformimet që mund të vijnë me kalimin e kohës.

Për volumin total që kalkuluam (350 m^3), i cili është relativisht i madh dhe për një sipërfaqe 2200 m^2 , përdorimi i një rruli të rëndë është jo vetëm i nevojshëm për cilësi, por edhe për efikasitet në kohë dhe kosto. Pse kërkohet si kriter tek mjetet e punës rruli gomë-hekur mbi 15 ton?

Kjo makineri së pari është ideal për ngjeshjen e çakëllit, pasi goma jep goditje më të buta dhe ndihmon në dendësim më të mirë të fraksioneve të imëta në çakëll kurse hekuri dhe pasha mbi 15 ton sigurojnë kompaktim të plotë dhe uniform në të gjithë sipërfaqen. So përfundim1 rrul gomë-hekur mbi 15 ton është i justifikuar dhe i domosdoshëm për të siguar :

1. Kompaktim të plotë
2. Qëndrueshmëri në kohë
3. Cilësi në përputje me standartet teknike

Betonierë 0.25 m^3

Lloji i punimit	Vëllimi total (m^3)
Puseta (tombino)	9.1 m^3
Murene tombino	14.0 m^3
Shtresa rrugore (struktura të holla)	105 m^3
Totali	128.1 m^3

Duke patur parasyshqë një betoniere me kapacitet $0.25 \text{ m}^3/\text{cikël}$ (zakonisht një përzierje zgjat = 10-12 minuta duke përfshirë ngarkim, përzierje, shkarkim), maksimumi praktik ditor për një betoniere (1 copë) do të jetë :

- Rreth $4-5 \text{ m}^3/\text{ditë}$ (nëse punohet me ujë ritëm të qëndrueshëm 6-7 orë në ditë)

Ky është një vlerësim i sigurt, duke llogaritur edhe kohën për lëvizje, ngarkim manual etj.,

Duke përlllogaritur ditët e punimeve me 1 betoniere nxjerrim :

$128.1 \text{ m}^3 \div 5 \text{ m}^3/\text{ditë} = 26 \text{ ditë pune}$, vetëm për betonime me 1 betoniere.

Në raport me grafikun e punimeve prej 48 ditëve dhe volumeve të larta të betonit që kërkohen në këto objekt, nevoja është për 2 betoniere 0.25 m^3 . Kjo argumentohet kështu :

- Ka ditëb që kërkohen volume të larta betoni (psh $> 8 \text{ m}^3$ në ditë) për shtresat rrugore.
- Duhet përfunduar strukturat brenda një periudhe të caktuar kohore.
- Kërkohen 2 fronte pune njëkohësisht (psh. pusetat + shtreë betoni rrugore).

Vibrator betoni

Ky mjet që përdoret gjerësisht në ndërtim, është shumë i nevojshëm edhe në këtë objekt si kriter i rëndësishëm në zërat e përmendur në preventive. Vibrator i betonit do të shërbejë për të eliminuar flluskat e ajrit dhe boshllëqet në beton, që janë shumë të rëndësishme për cilësinë dhe forcën e betonit. Gjithashtu vibratory i betonit duhet për të krijuar një densitet të lartë të betonit në elementët monolitë. Pa këtë pajisje, betoni mund të ketë dobësi strukturore dhe prirje për plasaritje. Për këto punime ndërtimore të bazuara në preventiv dhe grafik punimesh është e nevojshme 1 vibrator betoni 1100-1500 W në një faqe ndërtimi me 1 ekip.

Gjenerator

Në mbështetje të preventivit (zërave të punës) në këtë objekt do të marin pjesë edhe makineritë e lartpërmendura si vibrator i betonit, betonierja 0.25 m^3 , matrapiku etj. Të gjitha këto kanë nevojë të furnizohen me energji elektrike, e cila në këtë kantier është e vështirë deri e pamundur të sigurohet në

rrugë tjetër.

Pra:

Nevoja	Kapacitet gjeneratori
Puna e thjeshtë, vetëm betoniore ose vibrator njëherësh	6-7 KVA (kilovat-amper)
Puna e përditshme me 2-3 pajisje njëkohësisht	8-10 KVA (minimum i sigurt)

Për një kantier pune të tilla të zakonshëm, pra me një front pune, është i mjaftueshëm 1 gjenerator 8-10 KVA.

Mini dumper peshe 5-7 tom (MT) me targa

Si rezultat i gjërimeve të parashikuara në preventiv automatikisht do të prodhohen inerte, mbetje të dheut. Pikërisht kjo makineri është e duhura për të mbajtur pastër kantierin.

Duke qene se këto punime do të kryhen në një reliev të vështirë të pjerrët malor dhe të ngushtë kjo makineri shihet si e përshtatshme për levizjet në këto terrene.

Minidumperi shihet si i nevojshëm edhe si mjet ndihmës për transportin e çakëllit dhe materialeve të tyre mbushëse nga mangazina në vendin e punës. Gjithashtu vendosja e kësaj makinerie do ti japë përparësi edhe sjarkimit të shpejtë të materialeve me kupën e ngritur (dump).

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimum 15 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikësezjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Komploti ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma/Jelek pune 15 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimum 5 copë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).*
- Përmjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qiratetij.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundim të kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.*
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë

mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente
- ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalente
- ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Certifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra

ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për

informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti sipas kërkesave në DST, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga anëtarët specialistë të Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

ORGENT CONIKU

SAMUEL VELIU
ZOGU

LOINA

ZYRTARI I AUTORIZUAR
N/KRYETARI I BASHKISË
Tajar BICI